



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL
PËR MARRJEN E SHKALLËVE TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE
TË LËNDËS HISTORI
2019**

1. HYRJE

Aftësia e mësuesve për ta bërë arsimimin e nxënësve, “preokupimin” kryesor të ditës, kërkon përkushtim, përgjegjshmëri dhe standarde të larta në punë dhe sjellje. Mësuesit veprojnë me ndershmëri dhe integritet, kanë njohuri të forta përmbajtësore, përdorin dijet dhe aftësitë e tyre, por në të njëjtën kohë përditësojnë njohuritë nëpërmjet vetëvlerësimeve të vazhdueshme, krijojnë marrëdhënie pozitive profesionale dhe punojnë me prindërit në interesin më të mirë të nxënësve të tyre.

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të lëndës së historisë është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA) për t’u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të lëndës së historisë në përgatitjen për testimin kombëtar për marrjen e kategorive të kualifikimit si dhe të gjitha Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësuesit që do të hyjnë në këtë proces.

Ky program është hartuar në përgjigje të kërkesave që MASR-ja ka vendosur për mësuesit që kualifikohen. Programi është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- dokumentacioni zyrtar¹ shkollor, i cili ka të bëjë me veprimtarinë mësimore - edukative të mësuesve në shkollë.

¹ Dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MASR-së që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

- programe lëndore të historisë.
- aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut në procesin mësimdhënie
 - nxënie të lëndës së historisë.
- aspekte të etikës dhe të komunikimit.
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- përmbajtja shkencore e lëndës, sipas programeve lëndore të historisë.

2. QËLLIMI I PROGRAMIT

Qëllimi i hartimit të programit të zhvillimit profesional të mësuesve për efekt kualifikimi është:

- të ofrojë një program orientues për t'u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të lëndës së historisë në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese, si dhe DAR/ZA-ve, për të organizuar zhvillimin profesional të mësuesve. Në këtë aspekt programi mund të plotësohet nga DAR/ZA-të përkatëse, sipas kushteve dhe mundësive konkrete;
- të ofrojë një program të detyruar, për mësuesit që këtë vit do të marrin kategoritë e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje, për të përballuar me sukses kërkesat që ka testimi kombëtar.

Programi synon që mësuesi:

- të njohë dhe të zbatojë legjislacionin arsimor e në mënyrë të veçantë risitë më të fundit të reformës arsimore.
- të zotërojë kompetencat profesionale të kuadrit mësimdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësimdhënie të suksesshme.
- të demonstrojë aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e metodave për organizimin e klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorimin e teknikave të vlerësimit të nxënësve etj.
- të tregojë përgjegjshmëri në njohjen e koncepteve, kompetencave dhe ligjësive të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim.
- të demonstrojë zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë.
- të zotërojë zbatimin e rregullave drejtshkrimore të gjuhës shqipe gjatë procesit të mësimdhënie-nxënies.

- të përdorë aftësitë e TIK-ut, si një nga risitë më të fundit në mësimdhënien bashkëkohore.

3. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër. Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Për secilën fushë, përcaktohen:

- kompetencat profesionale, si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave;
- literatura përkatëse rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të fushës.

Përshkallëzimi i njohurive dhe aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë të testimit, do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përqëndrohet.

FUSHA “DOKUMENTACIONI ZYRTAR SHKOLLOR”	
Kompetenca	Literatura e rekomanduar
<p>“Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe dokumentacionit shkollor”</p>	
<p>Rezultate të pritshme</p> <p><i>Mësuesi i historisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar dhe dispozitat normative të këtij sistemi; • zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore; • zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës; • demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MASR-së në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënie-nxënies; • zbaton etikën profesionale të mësuesit; 	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. • Udhëzimi nr.27, datë 16.08.2018 “Për vitin shkollor 2018-2019 në sistemin arsimor parauniversitar”. • Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”. • Udhëzimi nr. 1, datë 20.01.2017 “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”. • Udhëzimi nr. 2, datë 12.02.2015. “Për kriteret

<ul style="list-style-type: none"> • respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit; • respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit; • zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit. 	<p>dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Udhëzimi nr. 34, datë 11.09.2015 “Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me kompetenca, në arsimin bazë”. • Udhëzimi nr. 14, datë 28.07.2016 “Për vlerësimin e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë”. • Urdhri Nr.6, datë 10.01.2018 për zbatimin e nismës “Tri lëndë në gjashtë orë”.
---	---

FUSHA “PROGRAME LËNDORE TË HISTORISË”

Kompetenca “Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të historisë në shkollë”	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultate të pritshme</p> <p><i>Mësuesi i historisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • zbaton programin duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij; • përshtat programin lëndor në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim; • përdor me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetin e zbatimit të programit; • gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në program; • gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin e nxënësve dhe nxitin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre; • harton rezultate të nxëni për tema mësimore ose grup temash, kapitujsh, në përputhje me njohuritë dhe shkathhtësitë e programit; • kategorizon rezultatet e të nxënit të programit sipas niveleve të arritjes së të nxënit; 	<ul style="list-style-type: none"> • Korniza kurrikulare, 2014. • Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat VI-IX dhe klasa X -XII.

<ul style="list-style-type: none"> • tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve të historisë); • përzgjedh mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e rezultateve të nxënësit të programit; • siguron informacion që demonstroi lidhjen e historisë me shkencat e tjera dhe me jetën reale. 	
--	--

FUSHA “ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK-UT NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE”	
Kompetenca I “Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e historisë”	Literatura e rekomanduar
<p><i>Mësuesi i historisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij; • përshtat punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të nxënësve; • demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit; • identifikoi nxënësit me nevoja të veçanta (nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe nxënësit e talentuar); • planifikoi punën afatshkurtër dhe afatgjatë me nxënësit me nevoja të veçanta; • demonstroi qëndrim pozitiv ndaj shkencës dhe lëndës së historisë; • edukoi të nxënësit dashurinë dhe kërkueshmërinë ndaj lëndës së historisë; • motivoi nxënësit duke e konsideruar motivimin një nga çelësat e progresit të tyre; • krijoi klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit; 	<ul style="list-style-type: none"> • Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015. • Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017 • Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në gjimnaz, 2016. • Udhëzues për kurrikulën me zgjedhje në gjimnaz, IZHA 2018. • Vlerësimi i nxënësit në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë. <i>(Material shpjegues në ndihmë të shkollave)</i>, nëntor 2018.

<ul style="list-style-type: none"> • punon me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit. 	
Kompetenca II “Përdorimi i metodave dhe strategjive efektive në mësimdhënien e historisë”	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultate të pritshme <i>Mësuesi i historisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një objekti të caktuar; • përdor metoda e teknika që nxisin mendimin e pavarur e krijues të nxënësve; • planifikon një orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin; • përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve; • përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen; • përdor proceset historike në mësimdhënien – nxënien e historisë; • demonstroi teknika të ndryshme për vlerësimin e nxënësit; • shpjegon parimet e hartimit të një testi; 	<ul style="list-style-type: none"> • Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017 • Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në gjimnaz, 2016. • Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), IZHA 2016. • Udhëzues për kurrikulën me zgjedhje në gjimnaz, IZHA 2018. • Vlerësimi i nxënësit në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë. (<i>Material shpjegues në ndihmë të shkollave</i>), nëntor 2018. • Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së historisë në arsimin e mesëm të ulët, dhjetor 2018. • Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së historisë në arsimin e mesëm të lartë, dhjetor 2018.
Kompetenca III “Përdorimi i teknologjinë së informacionit dhe komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në histori”	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultate të pritshme <i>Mësuesi i historisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • prezanton ngjarje/çështje historike duke përdorur 	<ul style="list-style-type: none"> • Tekste nxënësi apo materiale në ndihmë të mësuesit të lëndës së historisë që përdoren në klasat VI

<p>teknologji të përshtatshme si: Power Point, Excel, Word;</p> <ul style="list-style-type: none"> • nxit nxënësit të bëjnë kërkime dhe prezantime duke përdorur programe kompjuterike të njohura për ta; • gjen dhe përdor materiale nga website për të pasuruar dhe perfeksionuar mësimdhënie-nxënien; • përfshin nxënësit në projekte kurrikulare të lëndës së historisë apo në projekte kurrikulare të integruara të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime materialesh nga website dhe prezantime në Power Point, Prezi . 	<p>- IX të arsimit të mesëm të ulët si dhe në klasat X - XII të arsimit të mesëm të lartë dhe kanë në fokus përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie -nxënie.</p>
--	---

FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT	
Kompetenca “Zbatimi i rregullave të etikës dhe komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultate të pritshme <i>Mësuesi i historisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • njeh rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin; • sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> • Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar. • Draft-Standardet profesionale të mësuesit në arsimin parauniversitar, IZHA 2016.

FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE	
Kompetenca “Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe”	Literatura e rekomanduar
Rezultate të pritshme <i>Mësuesi i historisë:</i> <ul style="list-style-type: none"> • njeh rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe; • demonstroi zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.

FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS	
Kompetenca “Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e lëndës së historisë”	Literatura e rekomanduar
Rezultate të pritshme <i>Mësuesi i historisë:</i> <ul style="list-style-type: none"> • dallon konceptet dhe shprehjet kryesore me të cilat operon lënda e historisë në klasat 6-9 dhe klasat 10-12; • përshkruan mënyrën e formimit të koncepteve të historisë në klasat 1-9 dhe klasat 10-12; • përshkruan zhvillimin vertikal, nga njëri vit në tjetrin, të koncepteve dhe shprehjeve; • dallon ndërvarësinë e koncepteve historike nga njëri - tjetri dhe lidhjen me konceptet e lëndëve të tjera; • shqyrton një sërë interpretimesh të së kaluarës që i përkasin periudhave të ndryshme historike për të vlerësuar vlefshmërinë e tyre, bazuar në burimet historike; • shpjegon pasojat në përfundimin e ngjarjeve, të situatave dhe të ndryshimeve historike; • komunikon njohuritë historike në forma të ndryshme, duke 	<ul style="list-style-type: none"> • Programe dhe tekste të lëndës së historisë për mësuesin dhe nxënësin, si dhe materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës për klasat VI-IX për arsimin e mesëm të ulët dhe X - XII për arsimin e mesëm të lartë.

përdorur kronologjinë dhe fjalorin e duhur historik;

- ndërton linjën e kohës, duke vendosur në të periudhat dhe ngjarjet e rëndësishme historike;
- shpjegon shkallën dhe ritmin e ndryshimit, nëse ndryshimi arriti në progres dhe nëse po, për kë, për ngjarje/çështje të ndryshme historike;
- përdor burimet historike për të shpjeguar arsyet dhe rezultatet e ngjarjeve, situatave dhe ndryshimeve historike për periudha të ndryshme të historisë;
- dallon se si njerëzit dhe shoqëritë e përfshira në të njëjtën ngjarje historike mund të kenë përvoja dhe pikëpamje të ndryshme për të njëjtën ngjarje historike, bazuar në burimet historike;
- vlerëson rëndësinë e ngjarjeve, të njerëzve dhe të zhvillimeve historike në kontekstin e tyre historik dhe në ditët e sotme;
- interpreton efektin e kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në marrëdhëniet historike dhe rolin e tyre në perspektivat e së ardhmes
- vlerëson pozitën e qytetërimit shqiptar në raport me qytetërimet botërore;
- shpjegon vlerat e trashëgimisë historike, duke e vlerësuar këtë trashëgimi si pjesë të përcaktimit të identitetit të një populli
- demonstroi aftësi të kërkimit historik, duke u bazuar në burime historike për studimin e ngjarjeve të ndryshme të historisë.
- shpjegon se lënda e historisë është thelbësore në zhvillimin e qytetarëve, të cilët i kuptojnë çështjet aktuale me zgjuars, nëpërmjet kuptimit, analizës dhe përfundimeve të nxjerra nga përvojat e së shkuarës.